Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY

ARRU

ANALIZA E ASETEVE DHE INVESTIMEVE KAPITALE

VITI 2018

Gusht, 2019

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive 5
Hyrje 7
Historiku 8
Këndvështrimi i Investimeve Kapitale sipas ARRU 9
BRrA, zhvlerësimi dhe kthimi në kapital 10
Baza rregullatore e aseteve 10
Zhvlerësimi 10
Kthimi në kapital 11
Klasifikimi i investimeve sipas UKRR 13
Shkalla e realizimit të investimeve kapitale 14
Implikimi i mos realizimit të investimeve në procesin e tarifor pasues 18
Investimet e nevojshme në sektor 20
Analiza e gjatësisë së rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit 22
Analiza historike e gjatësisë së rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit 22
Numri i konsumatorëve dhe investimet në rritje të infrastrukturës 23
Analiza krahasuese ndërmjet KRU-ve 25
Konkluzionet e Analizës: 26
Rekomandimet e Analizës: 27
Shtojca Nr.1 Projektet e dorëzuara nga KRU dhe të Aprovuara nga ARRU për vitin 2018 28
Projektet e aprovuara për PR 29
Projektet e aprovuara për PZ 30
Projektet e aprovuara për PE 31
Projektet e aprovuara për MIT 32
Projektet e aprovuara për GJA 33
Projektet e aprovuara për FE 34
Projektet e aprovuara për GJI 35

Lista e figurave

Figura 1. Raporti i alokimit te aseteve në ujë dhe ujëra të ndotura 12

Figura 2. Klasifikimi i investimeve sipas Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator 14

Figura 3. Investimet vetanake për ujë dhe ujëra të ndotura 15

Figura 4. Investimet nga donacionet për ujë dhe ujëra të ndotura 16

Figura 5. Investimet totale për ujë nga burimet vetanake dhe nga donacionet 17

Figura 6. Trendi i gjatësisë së rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit ndër vite 23

Lista e tabelave

Tabela nr. 1. Baza e aseteve dhe zhvlerësimi për vitin 2018. 12

Tabela nr. 2. Shkalla e realizimit të investimeve kapitale prej burimeve vetanake për vitin 2018 15

Tabela nr. 3. Shkalla e realizimit të investimeve kapitale prej donacioneve në PR për vitin 2018..... 16

Tabela nr. 4. Shkalla e realizimit të investimeve kapitale vetanake dhe donacioneve për vitin 2018 17

Tabela nr. 5. Shkalla e realizimit të investimeve kapitale prej burimeve vetanake..... 19

Tabela nr. 6. Investimet e nevojshme duke u bazuar në BRrA dhe në numër të konsumatorëve 21

Tabela nr. 7. Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit për secilën KRU ndër vite 22

Tabela nr. 8. Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe investimet kapitale për secilën KRU .. 24

Tabela nr. 9. Numri i konsumatorëve dhe gjatësia e rrjetit për secilën KRU 25

Akronimet

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
BPRR	Biznes Planet Rregullatore
BRrA	Baza Rregullatore e Aseteve
FE	KRU “Bifurkacioni” sh.a Ferizaj
GJA	KRU “Gjakova” sh.a Gjakovë
GJI	KRU “Hidromorava” sh.a Gjilan
KPI	Kosto e Përtëritjes së Infrastrukturës.
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
MIT	KRU “Mitrovica” sh.a Mitrovicë
PE	KRU “Hidrodrini” sh.a Pejë
PR	KRU “Prishtina” sh.a Prishtinë
PZ	KRU “Hidroregjioni-Jugor” sh.a Prizren
PMA	Plani i Menaxhimit të Aseteve
Sektori	Zona e shërbimit cila është nën menaxhimin e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit që ofrojnë shërbime te ujësjellësit dhe grumbullimit të ujërave të ndotura
UKRR	Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator
Zhvlerësimi	I referohet zhvlerësimit sipas kostos aktuale, duke u bazuar në udhëzimet e kontabilitetit rregullator të ARRU

Përmbledhje Ekzekutive

Analiza mëton që të ofrojë Autoritetit një pasqyrë të gjendjes së aseteve dhe investimeve në sektorin e ujit dhe ujërave të zeza dhe veprimet e nevojshme që duhet ndërmarr ai, për ta përmirësuar edhe më tej gjendjen e sektorit të Ujit në Kosovë.

Me tarifat e procesit rregullatorë, ARRU ka mbështetur synimet e KRU-ve për investime të konsiderueshme në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e nivelit të shërbimeve të ujësjellësit dhe shërbimeve të ujërave të ndotura, duke e shqyrtuar me kujdes dinamikën e realizimit të projekteve investive kapitale. Të gjitha KRU-të janë të obliguara të paraqesin planifikimet e investimeve kapitale për procesin tarifor, duke klasifikuar ato sipas burimeve të financimit dhe kategorizuar sipas Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator.

Metoda në përcaktimin e vlerës së BRRA është bazuar duke kërkuar një metodë e cila u mundëson KRU-ve të realizojnë investimet kapitale në përmirësimin e nivelit të shërbimit si dhe në të njëjtën kohë duke u kujdesur që tarifat të jenë të përballueshme për konsumatorin.

Asetet të cilat janë financuar nga grantet, donacionet, të ndërtuara nga palët e treta dhe të adoptuara nga KRU pa ngarkesë apo kontribute kapitale, nuk përfshihen në bazën rregullatore të aseteve dhe asetet të cilat financohen pjesërisht përfshihen vetëm për vlerën e financuar nga kompania.

Sektori financiar i ujit në Kosovë nuk është një strukturë e sofistikuar e tregut dhe nuk ka në dispozicion informata statistikore në lidhje me primet e riskut dhe përdoren informatat statistikore nga vende tjera në mënyrë që të njëjtat të përdoren si një listë zëvendësuese e parametrave për përcaktim të normës së kthimit në kapital për sektorin e ujit në Kosovë.

Vlera e aseteve është më e madhe në shërbimet e ujit. Sektori i ujërave të ndotura në Kosovë nuk është akoma i zhvilluar në masën e duhur dhe se kërkohet që të bëhen investime të konsiderueshme. Prej vlerës së tërësishme të aseteve në sektor, 83% i përkasin shërbimeve të ujit kurse pjesa tjetër prej 16.6% ujërave të ndotura.

Disa prej ofrueseve të shërbimeve nuk kanë treguar performancë të mirë në realizimin e investimeve kapitale prej burimeve vetanake. ARRU duhet të ndërmarrë veprime, të cilat duhet të sensibilizojnë KRU-të që të jenë më të vëmendshme në këtë çështje dhe njëherësh që të sigurojë balancën në mes të ruajtjes së konsumatorit dhe qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimeve.

Rezultantë e mosrealizimit të investimeve kapitale, tek disa KRU, të aprovuara nga ARRU nga burimet e vetëfinancimit nga ana e KRU-ve, është se BRrA ka vlerë më të ulët sesa ajo e planifikuar, e cila si pasojë ka pasur kthim më të vogël në kapital. Kjo, në një mënyrë paraqet një vetë ndëshkim të ofruesëve të shërbimeve. Nga viti 2019, ARRU do t'i hulumtojë mundësitë që të korrigjohen tarifat në rastet kur investimet kapitale nga burimet vetanake nuk realizohen nga ana e KRU-ve.

Të gjitha KRU-të që arrijnë të realizojnë investimet vetanake sipas përcaktimit tarifor nga ARRU, nuk janë subjekt i trajtimit balancues me tarifën vijuese. Për të gjitha KRU-të tjera, diferenca e mos realizimit të investimeve do të shumëzohet me koeficientin 0.75 (75%) dhe ajo vlerë pastaj, në vitin e parë të procesit tarifor pasues do të zbritet nga shuma e shpenzimeve operative të KRU-së gjegjëse.

Nga këndvështrimi tjetër, sektori ka bërë investime mbi ato të aprovuara nga ARRU. Së këndejmi, ARRU në politikat tarifore duhet që të ketë politika stimuluese për ofruesit e shërbimeve që tejkalojnë investimet kapitale të aprovuara nga ARRU.

Sektori ujit posedon me 106,352,413.00€ Bazë Rregullatore të Aseteve, ARRU duhet të verifikojë realizimin e listës së projekteve të aprovuara, projekt për projekt, dhe këtë duhet ta bëjë me anë të një vizite të veçantë nëpër KRU-të gjegjëse. Në procesin e verifikimit të të dhënave për investimet kapitale nga burimet vetjake. KRU-të duhet të punojnë në PMA në mënyrë që të arrijnë të arsyetojnë listën e projekteve të investimeve kapitale që planifikojnë t'i realizojnë përgjatë një procesi tarifor. Ofruesit e shërbimeve duhet që t'i dorëzojnë në ARRU, për miratim, Planet Afatgjata të Investimeve Kapitale, të cilit plan duhet që edhe t'i përmbahen. Secila KRU duhet të respektojë një prag të caktuar të investimeve kapitale të cilat duhet të realizohen për një vit të caktuar.

Të dhënat për gjatësinë e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit duhet të rishikohen, bazuar në analizën e dhënë në këtë raport, pasi që këto të dhëna janë të një rëndësie të veçantë për Departamentin e Tarifave gjatë procesit tarifor.

Hyrje

Analiza e aseteve dhe investimeve kapitale në sektorin e ujit në Kosovë ofron një shtjellim, i cili nxit zhvillimin e idesë dhe veprimeve konkrete për të korrigjuar situatën e cila mbizotëron në sektor.

Analiza fillon me përshkrim të historikut të bazës së aseteve në aspektin rregullator, duke vazhduar me ecurinë e investimeve kapitale në sektor. Po ashtu, analiza jep sqarimet e duhura të politikave që aplikon Departamenti i Tarifave në Autoritetin Rregullator të Ujit. Përdoruesit e analizës marrin informacionet bazike të Bazës Rregullatore të Aseteve në sektor, politikave të zhvlerësimit sipas udhëzimit rregullator dhe politikat për kthimin e investimeve në kapital. Kjo, mbase paraqet një aspekt të rëndësishëm për zhvillimin e politikave menaxhuese dhe zhvillimore të aseteve dhe të investimeve në to.

Analiza ofron shpjegime se si zbërthehen investimet dhe impakti i tyre në zhvillimin e sektorit, përmes përfitimit të dyfishtë, njëri, përmes rritjes së bazës së aseteve rritet mundësia për një fitim latent të ofruesve të shërbimeve, duke përfituar kthimin në kapital, dhe tjetra, duke ngritur bazën e aseteve rritet edhe kuota e zhvlerësimit, e cila zgjeron mundësinë e përfitimit në investime shtesë.

Analiza ofron tabela dhe grafikone, të cilat thjeshtojnë të kuptuarit më të mirë të gjendjes në bazë analitike dhe të ofrimit të alternativave vepruese për të shtytur nxitjen më të përshpejtuar të zhvillimit të sektorit.

Së këndejmi, prezantohet qartë gjendja e investimeve, matur me projeksionet e përcaktuara zhvillimore dhe diskrepancat e derivuara, si rezultat i përkushtimit të nivelit aktual për të jetësuar caqet zhvillimore.

Analiza ofron opsione për ndërmarrjen e veprimeve për ta tejkaluar gjendjen dhe gjetjen e mundësive për prosperitet, duke ruajtur balancën në mes të cilësisë së shërbimeve, me përballueshmëri të ngarkesës së konsumatorit dhe qëndrueshmëri financiare të ofruesit të shërbimeve.

Analiza sjell konkluzionet e veta dhe ofron zgjidhje përmes rekomandimeve, të cilat do të duhet që të materializonin veprimet e aksioneve.

Kjo analizë vjetore e aseteve dhe investimeve kapitale, është fillimi i një spektri të analizave që do të ofroj Departamenti i Tarifave.

Historiku

Pas luftës së fundit të vitit 1999 Kosova trashëgoi një infrastrukturë të shkatërruar ku bën pjesë edhe sektori e ujit të pijshëm dhe kanalizimit. Në atë periudhë kohore llogaritej se përafërsisht 49 % e popullatës kishin qasje në sistemet publike për furnizim me ujë të pijes dhe vetëm 21 % të asaj pjese në rrjetin e grumbullimit të ujërave të ndotura. Pjesa tjetër e popullatës shfrytëzonte ujin nga puset, pa kurrfarë përpunimi elementar, e në anën tjetër gropat septike dhe rrjedhjet e lira të ujërave të zeza të saj sot e kësaj dite janë ende aktuale për këtë pjesë të popullatës në gjithë vendin.

Pasi që vendi në periudhën e pas luftës së fundit kishte trashëguar një infrastrukturë ujore shumë të dëmtuar dhe me një përqindje të vogël të mbulueshmërisë së popullatës me ujë të pijes dhe rrjet të pa mjaftueshëm të kanalizimit dhe me as një impiant për trajtim të ujërave të ndotura, ka vërtetuar konstatimin se ky sektor ka nevoja të mëdha për investime në sigurimin e burimeve të ujit, zëvendësimin e rrjetit të vjetruar të ujësjellësit dhe kanalizimit, zgjerimin e zonave të shërbimit për të gjithë banorët e Republikës së Kosovës dhe fillimin e trajtimit të ujërave të ndotura.

Nevojat për investime në sektorin e ujërave në Kosovë kanë qenë qenësore. Madje, para shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, Kosova si regjioni më i varfër, ka pasur rritje më të vogël ekonomike dhe mungesë të investimeve. Sidomos vitet 1990-ta ishin të karakterizuara me krizë të rëndë ekonomike. Situata ekonomike në Kosovë është përkeqësuar më tej nga lufta e cila përfundoi në vitin 1999, dhe që kishte rezultuar me një dëmtim të gjerë të infrastrukturës. Bashkësia ndërkombëtare shpejt ka kuptuar nevojën për tu përgjigjur.

Investimet gjatë fazës emergjente ishin drejtuar kryesisht në rehabilitimin e rrjetave të ujësjellësit të dëmtuara nga lufta dhe të objekteve të tjera të furnizimit me ujë, në mënyrë që të përmbushë kërkesat minimale për furnizimin e banorëve me ujë të pijes, në veçanti në zonat e prekura më së shumti nga lufta. Jo vetëm shkatërrimi nga lufta që ishte arsyeja për rehabilitimin e infrastrukturës për furnizimit me ujë dhe të ujërave të zeza, por mungesa e investimeve dhe mirëmbajtjes së dobët ndonjëherë gjatë viteve të nëntëdhjeta ishin edhe shkaqet e përkeqësimit të tyre.

Pas aprovimit të Rregullores së UNMIK-ut (2002/12) të vitit 2002 mbi themelimin e Agjencisë Kosovae të Mirëbesimit (AKM), të njëjtit iu dhanë autorizimet për administrimin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe publike ku bënin pjesë edhe ndërmarrjet e ujësjellësve dhe kanalizimeve të Kosovës. Njëri ndër hapat e parë të marra nga AKM-ja në sektorin e ujit ishte konsolidimi i 34 ndërmarrjeve publike shoqërore, në 7 kompani regjionale. Kjo iniciativë e filluar gjatë vitit 2002 ka përfunduar në vitin 2007 kur është bërë vlerësimi i aseteve dhe të njëjtat janë shndërruar në shoqëri aksionare të këtij sektori.

Me qëllim të kompletimit institucional të sektorit të ujit afërsisht në të njëjtën kohë kanë filluar përgatitjet për themelimin e Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina, i cili si organ i pavarur do të merrej me rregullimin ekonomik të kompanive regjionale të shërbimit të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave. Themelimi i kësaj zyre është bërë me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49, më 26 nëntor 2004 e cila pastaj është amandamentuar me Ligjin Nr. 03/L-086 të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më

datë 13 Qershor 2008 duke transferuar kështu përgjegjësitë për rregullimin e sektorëve të ujit dhe mbeturinave nga UNMIK tek Institucionet e Kosovës. Në vitin 2012 amandamentohet Ligjin Nr. 03/L-086 prej nga Rregullatorit i hiqen përgjegjësitë mbi rregullimin e sektorit të mbeturinave. Në vitin 2016 kemi amandamentimin e Ligjit 05/L – 042 prej nga Rregullatorit i jepen kompetenca të mëtejme në sektorin e ujit prej nga KRU-të duhet të dorëzojnë në ARRU për aprovim aktet që përfshijnë (i) Planet e Biznesit, (ii) Planet e Menaxhimit të Aseteve, (iii) Planet Afatgjata të Investimeve, (iv) Planet e Menaxhimit të Thatësisë, (v) Planet e Furnizimit me Ujë në Situata Emergjencave.

Këndvështrimi i Investimeve Kapitale sipas ARRU

Me tarifat e procesit rregullatorë ARRU ka mbështetur synimet e KRU-ve për investime të konsiderueshme në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e nivelit të shërbimeve të ujësjellësit dhe shërbimeve të ujërave të ndotura, duke e shqyrtuar me kujdes dinamikën e realizimit të projekteve investive kapitale.

Procesi tarifor, bartës i të cilit është ARRU, bartë në vete rëndësinë e veçantë investimet kapitale që KRU-të planifikojnë t'i realizojnë gjatë periudhës tre vjeçare, në këtë rast për vitet 2018-2020. Të gjitha KRU-të janë të obliguara të paraqesin planifikimet e investimeve kapitale për procesin tarifor, duke klasifikuar ato sipas burimeve të financimit dhe kategorizuar sipas Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator.

Për dallim prej herëve tjera të aplikimit tarifor, në procesin e fundit për të gjitha KRU-të, për nevoja thjeshtësie, është kërkuar që investimet kapitale të listohen në një listë të veçantë, të titulluar Shtojca nr .3, ku aty ofrohen informacione për (i) emrin e projektit, (ii) viti kur planifikohet të realizohet projekti, (II) shuma e financimit dhe (iv) burimi i financimit.

Element tjetër me rëndësi, për të cilën ARRU i ka kushtuar vëmendje të veçantë, ka qenë edhe arsyeshmëria e projekteve të investimeve kapitale. Deri më tani projektet e dorëzuara gjatë aplikimit tarifor kanë përmbajtur vetëm emrin e projektit, shumën dhe burimin e financimit, duke u nisur nga fakti se për këto projekte do duhej të ofroheshin shpjegime dhe arsyetime bindëse në Planet e Menaxhimit të Aseteve, ashtu siç parashihet edhe në Ligjin e ARRU.

Duke qenë në dijeni se asnjëra nga KRU-të nuk kishte arritur të dorëzonte plane të mirëfillta të menaxhimit të aseteve, të detyruar nga ky fakt, ARRU u bëri shkresë zyrtare të gjitha KRU-ve që të paktën të dorëzojnë dokumentacion përshkrues që arsyetojnë projektet e dorëzuara në BPRR.

Në këtë mënyrë, të gjitha KRU-të, përveç njërës, dorëzuan dokumentacion përcjellës të cilat ofruan informacione për:

- Përshkrimin e projektit,
- Arsyeshmërinë se përse projekti i caktuar duhet të realizohet nga KRU-ja, dhe
- Paramasën dhe parallogaritë e projektit të caktuar.

Dorëzimi i dokumentacionit përcjellës ka nënkuptuar njëherësh edhe pranimin e investimeve për të aprovuar nga ARRU-ja dhe me të cilat ngarkohen pastaj konsumatorët me tarifë.

BRrA, zhvlerësimi dhe kthimi në kapital

Baza rregullatore e aseteve

Puna për përcaktimin e BRRA ka filluar në vitin 2008, para se procesi i caktimit të tarifave të kalojë nga sistemi një vjeçar në sistem tre vjeçar. ARRU (në atë kohë ZRRUM) është përkrahur nga konsulenca ndërkombëtare për të caktuar vlerën e arsyeshme të BRRA-së.

Metoda në përcaktimin e vlerës së BRRA është bazuar duke kërkuar një metodë e cila u mundëson KRU-ve të realizojnë investimet kapitale në përmirësimin e nivelit të shërbimit si dhe në të njëjtën kohë duke shikuar që tarifat të jenë të përballueshme për konsumatorin, pra që të mos kishte ngritje të larta të tarifave.

Në atë kohë, ekipa e konsulentëve kanë konstatuar se vlera e aseteve nuk duhet që patjetër të jetë e barabartë me vlerën e aseteve në libra të kontabilititeti financiar. Ata patën theksuar përvojën nga Anglia dhe Uelsi ku vlera e aseteve për shërbimet e ujësjellësit është caktuar sipas kapitalizmit të tregut gjatë privatizimit e cila ka rezultuar me vlerë të aseteve sa 1/10-ta e vlerës së tyre në libra të kontabilitetit.

Analizave e ekipit të konsulencës, rezultuan se metoda më e arsyeshme dhe transparente për të gjitha KRR-të do të ishte që vlera e aseteve të bazohej në numrin e kyçjeve. Vlera financiare ishte testuar në disa nivele dhe si më e përshtatshmja është vendosur që vlera e aseteve për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura të jetë 200€ për kyçje të furnizimit me ujë dhe 100€ për kyçje të shërbimit në kanalizim.

Zhvlerësimi

Sipas UKRR asetet fikse të KRU-ve janë të ndara në dy kategori, në asete nëntokësore (apo infrastrukturore) dhe asete sipërfaqësore (jo-infrastrukturore).

Asetet nëntokësore nuk zhvlerësohen, ndërsa shpenzimet për të mirëmbajtur shërbimet ndaj konsumatorëve të kyçur në rrjet janë të përfshira në KPI.

Komponenti i asetit jo-infrastrukturor i vlerës fillestare, sipas UKRR-së, zhvlerësohet sipas metodës lineare gjatë 35 viteve). Zhvlerësimi në investimet e reja (pa përfshirë grantet) në asetet jo-infrastrukturore, bëhet duke përfshirë të gjitha asetet e blera apa të futura në funksion prej mesit të vitit fiskal.

Vlera e zhvlerësimit prandaj është 1/35-ta e vlerës fillestare të bazës rregullore të aseteve (të indeksuara deri në çmimet e vitit aktual) plus 0.5 x 1/35 e aseteve shtesë që investohen gjatë vitit.

Vlen të theksohet se sipas UKRR-së, asetet të cilat u dhurohen KRU-ve, atyre nuk u njihet zhvlerësimi në kalkulimin e tarifës. Pra, asetet të cilat janë financuar nga grantet, donacionet, të ndërtuara nga palët e treta

dhe të adoptuara nga KRU pa ngarkesë apo kontribute kapitale nuk përfshihen në bazën rregullatore të aseteve dhe asetet të cilat financohen pjesërisht përfshihen vetëm për vlerën e financuar nga kompania.

Pasi që vlera fillestare e BRrA është përshtatur me nivelin e çmimeve aktuale çdo vit duke e përdorur mesataren e statistikave të IÇK, dhe shpenzimet shtesë janë tashmë në çmimet aktuale, kjo metodë siguron që zhvlerësimi në Kontabilitetin Rregullator është gjithnjë në kushte të çmimeve aktuale prandaj do të jetë e mjaftueshme për të lejuar zëvendësimin e atyre aseteve në fund të jetëgjatësisë së tyre.

Kthimi në kapital

Në rishikimin tarifor 2012-2014 Rregullatori ka përdorur metodën e Modelit të Çmimit të Aseteve Kapitale – MÇAK (ang. CAPM).

CAPM paraqitet përmes kësaj formule:

$$\overline{\boldsymbol{r_a}} = \boldsymbol{r_f} + \boldsymbol{\beta_a}\left(\overline{\boldsymbol{r_m}} - \boldsymbol{r_f}\right)$$

Ku:

$\overline{r_a} = \textit{është norma e pritur e kthimit për asete}$

$r_f = \textit{Norma pa risk}$

$\beta_a = \textit{beta e asetit}$

$\overline{r_m} = \textit{norma e pritur e kthimit të tregut}$

Sektori financiar i ujit në Kosovë nuk është një strukturë e sofistikuar e tregut dhe nuk ka në dispozicion informata statistikore në lidhje me primet e riskut (mesatar ose për kompani individuale). Për më tepër, përcaktimi i një norme pa risk, për Kosovën nuk është i mundur, për shkak se ajo nuk është anëtare e Euro-zonës edhe pse përdorë Euron si valutë të saj. Megjithatë, është e mundur që të përdoren informatat statistikore nga vende tjera në mënyrë që të njëjtat të përdoren si një listë zëvendësuese e parametrave për përcaktim të normës së kthimit në kapital për sektorin e ujit në Kosovë.

Në rishikimin tarifor 2018-2020 me angazhimin e një eksperti ndërkombëtar, mbështetur në metodologjinë e sipër thënë, ARRU ka përcaktuar normën e kthimit në kapital në vlerën prej **4%**.

Tabela nr. 1. Baza e aseteve dhe zhvlerësimi për vitin 2018.

KRU	Kategoria e aseteve	Vlera financiare e aseteve në vitin 2018 (€)	Zhvlerësimi (€)
PR	Shërbimet e ujësjellësit	52,391,219	600,292
	Shërbimet e ujërave të ndotura	7,840,189	19,138
	Gjithsej	**60,231,408**	**619,430**
PZ	Shërbimet e ujësjellësit	7,529,440	61,515
	Shërbimet e ujërave të ndotura	2,487,835	2,227
	Gjithsej	**10,017,275**	**63,742**
PE	Shërbimet e ujësjellësit	7,791,951	59,888
	Shërbimet e ujërave të ndotura	1,581,561	3,165
	Gjithsej	**9,373,512**	**63,053**
MIT	Shërbimet e ujësjellësit	4,775,578	19,554
	Shërbimet e ujërave të ndotura	1,834,222	205
	Gjithseji	**6,609,799**	**19,759**
GJA	Shërbimet e ujësjellësit	10,041,251	140,612
	Shërbimet e ujërave të ndotura	1,722,059	12,750
	Gjithsej	**11,763,310**	**153,362**
FE	Shërbimet e ujësjellësit	3,469,319	19,043
	Shërbimet e ujërave të ndotura	818,895	6,606
	Gjithsej	**4,288,214**	**25,649**
GJI	Shërbimet e ujësjellësit	2,877,549	30,545
	Shërbimet e ujërave të ndotura	1,191,345	10,410
	Gjithsej	**4,068,895**	**40,955**
GJITHSEJ SEKTORI	Shërbimet e ujësjellësit	88,876,308	931,449
	Shërbimet e ujërave të ndotura	17,476,105	54,501
	Gjithsej	**106,352,413**	**985,950**

Siç mund të vërehet nga tabela, ndër KRU-të që ka vlerën më të madhe të aseteve, pa dyshim se është KRU "Prishtina", e cila ka vlerë më të madhe sesa të gjitha KRU-të së bashku. Kjo shpjegohet, se ajo ka numër më të madh të konsumatorëve si dhe ka futur në funksion edhe FPU Shkabaj, e cila është financuar nga kreditë (të cilat paguhen nga të hyrat e kompanisë), duke u ngarkuar baza rregullatore e aseteve të saj.



Figura 1. Raporti i alokimit te aseteve në ujë dhe ujëra të ndotura

Shikuar nga aspekti i pjesëmarrjes së aseteve në shërbimet e ujit dhe të ujërave të ndotura, s'do mend se vlera e aseteve është më e madhe në shërbimet e ujit. Kjo, njëherësh ofron edhe një pasqyrë se sektori i ujërave të ndotura në Kosovë nuk është akoma i zhvilluar në masën e duhur dhe se kërkohet që të bëhen investime të konsiderueshme në këtë drejtim. Prej vlerës së tërësishme të aseteve në sektor, 83% i përkasin shërbimeve të ujit kurse pjesa tjetër prej

16.6% ujërave të ndotura. Konsiderojmë se analiza e tillë do të jetë udhërrëfyes për sektorin, për të shumëfishuar përpjekjet e përmirësimit të kësaj strukture.

Klasifikimi i investimeve sipas UKRR

Sipas UKRR-s, investimet kapitale janë klasifikuar si investime në **shërbimet ujësjellësit** dhe **shërbimet e ujërave të ndotura.**

I. Investimet në shërbimet e ujësjellësit:

- Investime në resurse dhe trajtim të ujit,
- Investime në distribuim, dhe
- Investime në aktivitete biznisore.

II. Investimet në shërbimet e ujërave të ndotura:

- Investime në grumbullimin e ujërave të ndotura,
- Investime në trajtimin ujërave të ndotura,
- Investime në trajtimin dhe derdhjen e llumit, dhe
- Investime në aktivitete biznisore

Investimet në asetet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura ndahen në: **asete të infrastrukturës** dhe **ato të jo-infrastrukturës**

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** janë të ndara në investime: *(i)* të cilat bëhen për qëllime të përtëritjes infrastrukturës, *(ii)* dhe në investime të rritjes së infrastrukturës. Këto Investime karakterizohen si investime në asete nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësor, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha investimet në asetet mbitokësore: *(i)* fabrikat për trajtimin e ujit, *(ii)* ndërtesat administrative, *(iii)* mjetet transportuese, *(iv)* pajisjet për zyrë etj. Ky grup i investimeve mandej kategorizohet në investime të mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes së jo-infrastrukturore.

Për t'u njoftuar më në detaje për këto kategorizime mund të gjenden shpjegime në UKRR të cilat janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të ARRU. Po ashtu figura në vijim paraqet skematikisht këtë ndarje.



Figura 2. Klasifikimi i investimeve sipas Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator

Shkalla e realizimit të investimeve kapitale

Tabelat në vijim paraqesin shkallën e realizimit të investimeve kapitale gjatë vitit 2018 për secilën KRU. Kjo është arritur duke marrë për bazë fillimisht të dhënat e investimeve të aprovuara nga ARRU gjatë vitit 2018 si dhe duke marrë për bazë të dhënat e realizuara nga KRU-të, të cilat njëherit paraqesin të dhëna të audituara. Duhet theksuar se auditimi i të dhënave bëhet në baza të rregullta vjetore, prej nga me vendim të Drejtorit krijohet Komisioni i Auditimit, i cili udhëhiqet nga Departamenti i Performancës, ku vizitohet secila KRU në Kosovë dhe auditohen të dhënat e dorëzuara nga konteksti i saktësisë dhe besueshmërisë.

Shkalla e realizimit të investimeve, është bërë duke futur në funksion të dhënat e realizuara në raport me ato të aprovuara. Për çështje thjeshtësie, investimet janë kategorizuar vetëm në shërbimet e ujit dhe në ato të shërbimeve të ujërave të ndotura. Aty janë të paraqitura të gjitha KRU-të dhe në fund mund të analizohet edhe si ka performuar sektori në përgjithësi.

Tabela nr. 2. Shkalla e realizimit të investimeve kapitale prej burimeve vetanake për vitin 2018

KRU	Kategoria e investimeve kapitale	Aprovuara nga ARRU	Realizuara nga KRU	Shkalla e realizimit
PR	Shërbimet e ujësjellësit	388,500	2,764,676	712%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	262,500	800,342	305%
	Totali	**651,000**	**3,565,018**	**548%**
PZ	Shërbimet e ujësjellësit	490,581	260,509	53%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	122,100	10,777	9%
	Totali	**612,681**	**271,286**	**44%**
PE	Shërbimet e ujësjellësit	489,600	307,427	63%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	81,400	10,835	13%
	Totali	**571,000**	**318,262**	**56%**
MIT	Shërbimet e ujësjellësit	300,000	26,174	9%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	50,000	2,908	6%
	Totali	**350,000**	**29,082**	**8%**
GJA	Shërbimet e ujësjellësit	936,567	2,858,057	305%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	57,800	10,979	19%
	Totali	**994,367**	**2,869,036**	**289%**
FE	Shërbimet e ujësjellësit	45,000	9,691	22%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	120,000	3,786	3%
	Totali	**165,000**	**13,477**	**8%**
GJI	Shërbimet e ujësjellësit	170,000	168,947	99%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	50,000	248	0%
	Totali	**220,000**	**169,195**	**77%**
SEKTORI	Shërbimet e ujësjellësit	2,820,248	6,395,480	227%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	743,800	839,875	113%
	Totali	**3,564,048**	**7,235,355**	**203%**



Figura 3. Investimet vetanake për ujë dhe ujëra të ndotura

Tabela nr. 3. Shkalla e realizimit të investimeve kapitale prej donacioneve në PR për vitin 2018

KRU	Kategoria e investimeve kapitale	Aprovuara nga ARRU	Realizuara nga KRU	Shkalla e realizimit
PR	Shërbimet e ujësjellësit	42,200	8,029,713	19028%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	0	1,090,589	!
	Totali	**42,200**	**9,120,302**	**21612%**
PZ	Shërbimet e ujësjellësit	6,376,913	12,820	0%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	7,244,000	0	0%
	Totali	**13,620,913**	**12,820**	**0%**
PE	Shërbimet e ujësjellësit	0	77,228	!
	Shërbimet e ujërave të ndotura	1,200,000	0	0%
	Totali	**1,200,000**	**77,228**	**6%**
MIT	Shërbimet e ujësjellësit	3,765,722	1,325,254	35%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	471,065	9,593	2%
	Totali	**4,236,787**	**1,334,847**	**32%**
GJA	Shërbimet e ujësjellësit	1,426,800	4,525,123	317%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	5,612,500	33,963	1%
	Totali	**7,039,300**	**4,559,086**	**65%**
FE	Shërbimet e ujësjellësit	565,000	0	0%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	300,000	0	0%
	Totali	**865,000**	**0**	**0%**
GJI	Shërbimet e ujësjellësit	2,640,000	401,371	15%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	3,000,000	0	0%
	Totali	**5,640,000**	**401,371**	**7%**
SEKTORI	Shërbimet e ujësjellësit	14,816,635	14,371,509	97%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	17,827,565	1,134,145	6%
	Totali	**32,644,200**	**15,505,654**	**47%**



Figura 4. Investimet nga donacionet *për ujë dhe ujëra të ndotura*

Tabela nr. 4. Shkalla e realizimit të investimeve kapitale vetanake dhe donacioneve për vitin 2018

KRU	Kategoria e investimeve kapitale	Aprovuara nga ARRU	Realizuara nga KRU	Shkalla e realizimit
PR	Shërbimet e ujësjellësit	430,700	10,794,389	2506%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	262,500	1,890,931	720%
	Totali	**693,200**	**12,685,320**	**1830%**
PZ	Shërbimet e ujësjellësit	6,867,494	273,329	4%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	7,366,100	10,777	0%
	Totali	**14,233,594**	**284,106**	**2%**
PE	Shërbimet e ujësjellësit	489,600	384,655	79%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	1,281,400	10,835	1%
	Totali	**1,771,000**	**395,490**	**22%**
MIT	Shërbimet e ujësjellësit	4,065,722	1,351,428	33%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	521,065	12,501	2%
	Totali	**4,586,787**	**1,363,929**	**30%**
GJA	Shërbimet e ujësjellësit	2,363,367	7,383,180	312%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	5,670,300	44,942	1%
	Totali	**8,033,667**	**7,428,122**	**92%**
FE	Shërbimet e ujësjellësit	610,000	9,691	2%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	420,000	3,786	1%
	Totali	**1,030,000**	**13,477**	**1%**
GJI	Shërbimet e ujësjellësit	2,810,000	570,318	20%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	3,050,000	248	0%
	Totali	**5,860,000**	**570,566**	**10%**
SEKTORI	Shërbimet e ujësjellësit	17,636,883	20,766,989	118%
	Shërbimet e ujërave të ndotura	18,571,365	1,974,020	11%
	Totali	**36,208,248**	**22,741,009**	**63%**



Figura 5. Investimet totale për ujë nga burimet vetanake dhe nga donacionet

Implikimi i mos realizimit të investimeve në procesin e tarifor pasues

Metodologjia tarifore që aplikon ARRU për sektorin e ujit dhe ujërave të ndotura në Kosovë, ka vërtetuar që është një metodologji e qëndrueshme e cila u ka mundësuar KRU-vë që të kenë qëndrueshmëri financiare, veçanërisht kthimi në kapital ka ruajtur nivelin e rrjedhës së parasë, edhe në rastet kur KRU-të kanë realizuar investime kapitale nga kreditë. Kjo në veçanti është evidente tek rasti i KRU "Prishtina".

Përgjatë këtyre viteve të rregullimit ekonomik të sektorit, në disa raste KRU-të kanë performuar mirë kurse në raste të tjera performanca e tyre nuk ka arritur ta përmbush pritshmërinë, veçanërisht tek efikasiteti i shpenzimeve operative dhe shkalla e arkëtimit. Po ashtu, sektori nuk ka performuar në nivel të kënaqshëm tek pjesa e zvogëlimit të humbjeve të ujit si dhe në realizimin e investimeve kapitale prej burimeve vetjake.

Mos realizimi i investimeve kapitale prej burimeve vetjake, nënkupton se konsumatorët kanë paguar tarifa për investimet që nuk kanë ndodhur.

Arsyeja se përse nuk janë realizuar investimet kapitale, tek disa orfrues të shërbimeve, konsiston:

1. KRU-të nuk kanë arritur të realizojnë shkallën e planifikuar të arkëtimit, e që kjo ka ndikuar pastaj të mos kenë rrjedhë të mjaftueshme të parasë.
2. KRU-të nuk janë treguar efektive në zvogëlimin e shpenzimeve operative, e cila pastaj ka rezultuar që të shpenzojnë më shumë dhe kështu të mos kenë mjete financiare në dispozicion për të realizuar investime
3. Paratë e mbetura në dispozicion kanë qenë të pa mjaftueshme për të implementuar programin e investimeve
4. Po ashtu mosndëshkimi i KRU-ve nga ARRU-ja (përmes UTSH-së vijuese) për këto dështime në investime, nuk ka intensifikuar përpjekjet e tyre shtesë
5. Mos zgjerimi i bazës së konsumatorëve
6. Shkalla jo e kënaqshme e faturimit

Disa prej ofruesve e shërbimeve nuk kanë treguar performancë të mirë në realizimin e investimeve kapitale prej burimeve vetanake. ARRU duhet të ndërmarrë veprime, të cilat duhet në masë të madhe të sensibilizojnë KRU-të që të jenë më të vëmendshme, dhe njëherësh që të sigurojë balancën në mes të ruajtjes së konsumatorit dhe qëndrueshmërisë financiare të ofruesëve të shërbimeve.

Përmes tabelës vijuese, do t'i vëreni impaktet në bazën e aseteve dhe kthimit në kapital si dhe ngarkesën e faturës së konsumatorit pa kthim të kundërvlerës në investime.

Tabela nr. 5. Shkalla e realizimit të investimeve kapitale prej burimeve vetanake

KRU	Kategoria e investimeve kapitale	Aprovuara nga ARRU	Realizuara nga KRU	Diferenca	Reduktimi i shpenzimeve
(a)	(b)	(c)	(d)	(e=c-d)	(f = 0.75 · d)
PR	Shërbimet e ujësjellësit	388,500	2,764,676	2,376,176	n/a
	Shërbimet e ujërave të ndotura	262,500	800,342	537,842	n/a
	Totali	**651,000**	**3,565,018**	2,914,018	n/a
PZ	Shërbimet e ujësjellësit	490,581	260,509	-230,072	-172,554
	Shërbimet e ujërave të ndotura	122,100	10,777	-111,323	-83,492
	Totali	**612,681**	**271,286**	-341,395	-256,046
PE	Shërbimet e ujësjellësit	489,600	307,427	-182,173	-136,630
	Shërbimet e ujërave të ndotura	81,400	10,835	-70,565	-52,924
	Totali	**571,000**	**318,262**	-252,738	-189,554
MIT	Shërbimet e ujësjellësit	300,000	26,174	-273,826	-205,370
	Shërbimet e ujërave të ndotura	50,000	2,908	-47,092	-35,319
	Totali	**350,000**	**29,082**	-320,918	-240,689
GJA	Shërbimet e ujësjellësit	936,567	2,858,057	1,921,490	n/a
	Shërbimet e ujërave të ndotura	57,800	10,979	-46,821	-35,116
	Totali	**994,367**	**2,869,036**	1,874,669	n/a
